



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 29 maj 2020, përmes mjeteve të komunikimit elektronik në distancë, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Artan Zhiva, autorizuar për përsëritje shërbimit të programit audioviziv të të tretëve “TV kabllor Inkusat” në njësitë Administrative Udënisht dhe Buçimas”. (**Vendimi nr. 41, datë 29.05.2020**)
2. “Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Albanian Fiber System” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve “TV kabllor AFS”, në njësitë Administrative Shalës dhe Pogradec”. (**Vendimi nr. 42, datë 29.05.2020**)
3. “Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënie licencës së transmetimit audio analoge në Qarkun Gjirokastrë dhe Bashkinë Sarandë”. (**Vendimi nr. 43, datë 29.05.2020**)

Në këtë mbledhje AMA shqyrtoi projektvendimin për heqjen e licencës së shoqërisë “RTV-RE.AL” sh.p.k., për subjektin audioviziv “Tv Re.AL”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare për një vit, vendimmarrje, e cila u shty për shkak të mungesës së kuorimit të nevojshëm.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 29 maj 2020**